SHOQERIA "FORALB ALABASTER" Shpk

VENDIMI I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE "FORALB ALABASTER" Sh.p.k.

Sot me dt. 04.04.2007, ne mbledhjen e asamblese se zakonshme te shoqerise "FORALB ALABASTER" shpk, ortaket

1.- **Shoqeria „ARREDAMENTI LEONÇIN"Shpk,** rregjistruar me 26.04.1991 prane Dhomes se Tregetise e Industrise Artizanatit dhe Bujqesise–Forli te leshuar me 05.03.2007, me ortake: *ENEA LEONÇINI, MARIA ANNA GARZANTI, ROBERTO LEONÇINI STEFANO LEONÇINI dhe ANETA LEONÇINI* , te perfaqesuar me Prokuren Speciale Nr.35096 Rep. Date 19.01.2007 te vertetuar nga Noteri ne FORLI, Z. MARIO DE SIMONE nga Z.Enea Leoncini

2.- **Ortaku shteteror, Z.Vasil Pano**, I cili ka cilesine e perfaqesuesit ne baze te urdherit nr.392 dt.26.05.2006 dhe autorizimit Nr.2016/1 date 30.03.2007 te leshuar nga Ministri I Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes Z. Genc Ruli, ne perputhje me kompetencat qe ka ne statutin dhe aktin e themelimit te kesaj shoqeri, dhe ne zbatimin e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare", Ligjit nr. 8885 dt. 22.04.2002,

sipas rendit te dites se njoftuar me pare, zhvilluan mbledhjen e Asamblese se Zakonshme:

1. *Rikofirmimin e vendimeve te asamblese te mbajtura ne proces verbalin e dates 26.05.2006, bazuar ne urdhrine METE-s Nr.392 date 26.05.2006 si dhe shkresen Nr.3344/1 date 26.05.2006*

2. *Ndryshimin e emrave te ortakeve*

Ne perfundim me unanimitet

V E N D O S E N :

1. Rikorfimimin e vendimeve te mbajtura ne proces verbalin e dates 26.05.2006 per pranimin e perfaqesueit te ri te ortakut shtet Z:Vasil Pano bazuar ne urdherin nr. 392 dt. 26.05.2006 leshuar nga Ministri i **Ministrise se Ekonomise, e Tregetise dhe Energjitikes**, Z. Genc Ruli.

2. Emerimin e Z.Enea Leoncini me cilesine e administratorit te ri te shoqerise "FOR ALABASTER" shpk

3. Ndryshimin ne nenin 19 te satutit i cili behet: *Aktiviteti i shoqerise zgjat 20 vjet duke filluar nga data e ndryshimit ne Gjykate,*

4. Ndryshimin e nenit 2 te kontrates te themelimit te shoqerise i cili behet:

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per 20 (njezet) vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregetar te ketij ndryshimi ne Gjykate. Shoqeria do ta kene seline e saj ne Mengaj –Kavaje

5. *Ndryshimin e ortakut te shoqerise italiane "ARRENDAMENTI LEONÇINI"shpk duke mbetur vetem Z. ENEA LEONÇINI .*

Ngarkohet Z: Enea Leoncini te beje ndryshimet perkatese ne gjykate

Ortaku Italian
Shoqeria "ARENDAMENTI LEONCINI"shpk
Me prokure
Enea LEONCINI

ENEA LEONCINI

"Ministria e Ekonomise, e Tregetise dhe Energjitikes
Perfaqesuesi i Ortakut shtet
Vasil PANO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR 1148 **REP**
NR 382/3 **KOL**

V E R T E T I M

Sot me daten 17/04/2007(dymijekater), diten e marte, ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje noteres Shpresa Kurti, me seli ne rrugen e "Durresit" mu paraqit :

1. **Shoqeria „ARREDAMENTI LEONÇIN"Shpk**, rregjistruar prane Dhomes se Tregetise e Industrise Artizanatit dhe Bujqesise–Forli te leshuar me 05.03.2007, me ortake: ENEA LEONÇINI, MARIA ANNA GARZANTI, ROBERTO LEONÇINI STEFANO LEONÇINI dhe ANETA LEONÇINI, te perfaqesuar me Prokuren Speciale Nr.35096 Rep. Date 19.01.2007 te vertetuar nga Noteri ne FORLI, Z. MARIO DE SIMONE nga Z.Enea Leoncini, shtetas italian i biri i Antonios dhe Anites, lindur ne Rocca San Casciano Forli- Itali me date 06.08.1942, me pashaporte Nr.744515M, me qendrim prane AIRE, Ambasada Italiane-Tirane,

2. **Ministria e Ekonomise, e Tregtise dhe Energjitikes**, perfaqesuar ne baze te urdherit nr.2016/1 Prot. Date 30.03.2007, nga Z.Vasil Pano, i biri i Kocos dhe Anes, lindur ne Korce me date 21.12.1948., banues ne Tirane, rruga „Q Stafa", Nr.181, me leternjoftimi UG Nr.011701.

Te lartpermendurit jane madhore, me zotesi te plote juridike, te cilet me deklaruan se sa siper eshte *vendimi i mbledhjes se Asamblese se zakonshme te ortakeve* per ndryshime ne Shoqerine "FORALB ALABASTER" shpk, i redaktuar jashte kesaj zyre dhe e nenshkruan me vullnetin e lire dhe te plote ne Zyren e Noterise Tirane ne prani te perkthyeses Albana Ahmeti. Une Noterja e vertetoj rregulisht.

Perkthyese
Albana Ahmeti

PULLE TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R E
SHPRESA KURTI

4. Shkresa Nr. 3344/1 dt. 26.05.2006 leshuar nga Ministri i Ministrise se Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes Z. Genc Ruli me lenden "Qendrimi qe do te mbahet ne mbledhjen e asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ne sh.p.k. "For Alb Alabaster", Kavaje .
5. Vendimi i Dhomes se tregtise e Industrise Artizanatit dhe bujqesise –Forli Cesena me Nr. Prot. VIVW/2085/2007/CF00132 date 05.03.2007,.
6. Prokura Nr.35096 Rep. Date 19.01.2007 te Noterit Marido De Simone , te Forlit-Itali.
7. Shkresa Nr. 2016/1 date 30.03.2007 te Z. GENC RULI, Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.

Ne perfundim ortaket pasi e lexuan proces verbalin e neneshkruajne me vullnet te lire dhe te plote ne prani te perkthyeses Albana Ahmeti.

"FORALB ALABASTER"SHPK
ORTAKET:

1.Ortaku Italian
Shoqeria "ARENDAMENTI LEONCINI"shpk
Perafesuar me prokure nga
Enea LEONCINI

2."Ministria e Ekonomise, e Tregetise dhe Energjitikes
Perfaqesuesi i Ortakut shtet
Vasil PANO

Perkthyese:
Albana AHMETI

NOTERE
SHPRESA KURTI

Nr. 9981 Rep.

SHOQERIA "FORALB ALABASTER"shpk

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTERIA TIRANE

Proces-Verbal
per mbledhjen e zakonshme te ortakeve te
"FORALB ALABASTER"shpk
date 04.04.2007

Ne Tirane sot me date **04.04.2007 ora.17.00**, diten e merkure, ne Zyren e Noterise Tirane, para meje Noteres SHPRESA KURTI, u mblodh asambleja e zakonshme e ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufzuar " FORALB ALABASTER" sh.p.k. me rend dite si me poshte:

1. *Rikofirmimin e vendimeve te asamblese te mbajtur ne proces verbalin e dates 26.05.2006, bazuar ne urdherin e METE-s Nr.392 date 26.05.2006 si dhe shkresen Nr.3344/1 date 26.05.2006*

2. *Ndryshimin e emrave te ortakeve.*

Te pranishem ne mbledhje jane:

1. **Shoqeria „ARREDAMENTI LEONÇIN"Shpk,** rregjistruar me 26.04.1991 prane Dhomes se Tregetise e Industrise Artizanatit dhe Bujqesise–Forli te leshuar me 05.03.2007, me ortake: *ENEA LEONÇINI, MARIA ANNA GARZANTI, ROBERTO LEONÇINI STEFANO LEONÇINI dhe ANETA LEONÇINI* , te perfaqesuar me Prokuren Speciale Nr.35096 Rep. Date 19.01.2007 te vertetuar nga Noteri ne FORLI, Z. MARIO DE SIMONE nga Z.Enea Leoncini, shtetas italian i biri i Antonios dhe Anites, lindur ne Rocca San Casciano Forli- Itali me date 06.08.1942, me pashaporte Nr.744515M, me qendrim prane AIRE, Ambasada Italiane-Tirane,

2. **Ministria e Ekonomise, e Tregtise dhe Energjitikes,** perfaqesuar ne baze te urdherit nr.2016/1 Prot. Date 30.03.2007, nga Z.Vasil Pano, i biri i Kocos dhe Anes, lindur ne Korce me 21.12.1948, banues ne Tirane, rruga „Qemal Stafa", Nr.181, me leternjoftimi UG Nr.011701.

E pranishe eshte dhe perkthyesja **Znj.Albana Ahmeti**.

Ortaku i pales italiane te shoqerise z.Enea Leoncini e deklaron mbledhjen te hapur mbasi prezent eshte 100% e kuotave dhe deklaron :

Shoqeria "FORALB ALABASTER"shpk eshte rregjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane person juridik me Vendimin Nr. 7100 date 04 Nentor 1994, me kapital themeltar 30.98 milion leke e krijuar nga ortaket:

1. **Shoqeria „ARREDAMENTI LEONÇINI"Shpk,**shoqeri italiane, regjistruar me date 26.04.1991 ne Dhomen e Tregtise e Industrise, Artizanatit dhe bujqesise e Forli Cesena-Itali, e perbere nga ortaket: ENEA LEONÇINI, MARIA ANNA GARZANTI, ROBERTO LEONÇINI STEFANO LEONÇINI dhe ANITA LEONÇINI, te cilet kane emeruar Z. ENEA LEONÇINI qe ti perfaqesoje ne

asamblene e ortakeve te shoqerise ,FORALB ALABASTER' shpk me te drejte dhe te saktesoje apo modifikoje emrin e ortakut italian, ***me kapital 23.2 milion leke.***

2. **Ortaku Shtet Ministria e Ekonomise, e Tregtise dhe Energjitikes,** qe perfaqeson Ndermarrjen „Miniera Krip Gipsit Mengaj", Perfaqesuar nga Z. VASIL PANO, ***me kapital 7.75 milion leke.***

Ne mbledhejn e asamblese se ortakeve ne date 26.05.2006 eshte vendosur :

1.- *Pranimi i perfaqsuesit te ri te ortakut SHTET, Z.VASIL PANO ne baze te urdherit Nr.392 date 26.05.2006 leshuar nga Z.GENC RULI- Minister i Ministrise se Ekonomise e Tregtise dhe Energjitikes.*

2.- *Emerimi i Z. ENEA LEONÇINI administrator te ri te Shoqerise .*

3.- *Ndryshimin e Nenit 19 te Statutit te shoqerise „For Alb Alabaster"shpk*

nga	*„aktiviteti i shoqerise zgjat ne 11 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykate ose me shpejt apo me vone , sipas propozimit te bere nga nje prej ortakeve te aprovuar nga Asambleja e ortakeve ne shumicen e parashikuar ne ligjen 7638 date 19.11.1992 ,*
eshte vendosur qe :	*„Aktiviteti i shoqerise zgjat 20 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykate.*

4. *Ndryshimi i Nenit 2 te Akt Themelimit te shoqerise „For Alb Alabaster"shpk*

Nga	*„shoqeria do te ushtroj aktivitetin per 11 vjet nga data e regjistrimit ne rregjistrin tregtar, ne Gjykaten e rrethit Tirane",*
eshte vendosur qe:	*„Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per 20 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne rrgjistrin tregtar te ketij vendimi ne Gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane.*

SELIA mbetet ne MENGAJ KAVAJE.

- Z.ENEA LEONÇINI propozoi

qe vendimet e marra ne mbledhjen e dates 26.05.2006 te qendrojne ne fuqi, dhe propozoi ne baze te kompetencave te prokures qe ka nga ortaket e Shoqerise Italiane "ARENDAMENTI LEONÇINI" shpk,
te jete i vetmi perfaqsues i kesaj Shoqerie ne Shqiperi per ne Shoqerine "FORALB ALABSTER" shpk.

perfaqsues

- Edhe Z. Vasil Pano, i cili eshte pranuar ortak i ri i pales SHTET ne baze te urdherit te Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Z. Genc Ruli me nr. 392

dt. 26.05.2006, dhe ne kete mbledhje eshte perfaqesues ne baze te shkreses Nr. 2016/1 date 30.03.2007, **miraton**

rikonfirmimin e vendimeve te asamblese te mbajtuar ne proces verbalin e date 26.05.2006

dhe
ndryshimin e ortakut te Shoqerise "AREDAMENTI LEONÇINI"shpk duke mbetur perfaqsues i vetem i kesaj shoqerie Z.ENEA LEONCINI per ne Shoqerine "FORALB ALABASTER" shpk.

Ortaket bien dakort qe per depozitimin e dokumentave prane regjistrit tregtar te Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane te caktohet Z.ENEA LEONÇINI.

Per sa u tha me siper, te dy ortaket pranuan se ndryshimet e bera jane te domosdoshme, per vazhdimin e ketij aktiviteti dhe prandaj asambleja me unanimitet:

VENDOSI

Rikorfimimin dhe miratimin e Vendimeve te mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te dates 26.05.2006 me ndryshimet perkatese :

1.1 *Miratimin e perfaqesuesit te ri te ortakut shtet Z.Vasil Pano bazuar ne urdherin nr. 392 date26.05.2006 leshuar nga Ministri i Ministrise se Ekonomise, e Tregtise dhe Energjitikes, Z.Genc Ruli.*

1.2 *Miratimin e emerimit Z Enea Leoncini me cilesine e perfaqesuesit te vetem dhe administratorit te ri te shoqerise "FORALB ALABASTER"shpk.*

1.3 *Miratimin e ndryshimit te nenit 19 te satutit :"Aktiviteti i shoqerise zgjat 20 vjet duke filluar nga data e ndryshimit ne Gjykate",*

1.4 *Miratimin e ndryshimit* te nenin 2 te kontrates te themelimit te shoqerise: *Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per 20 (njezet) vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregetar.*
Shoqeria do ta kene seline e saj ne Mengaj –Kavaje

2. *Perfaqesuesi i Vetem i Shoqerise Italiane "Aredamenti Leoncini"shpk, per ne shoqerine "FORALB Alabaster"Shpk, eshte Enea Leoncini.*

Ngarkohet Z: Enea Leoncini te beje ndryshimet perkatese ne gjykate;

Pjese e ketij proces verbali jane:

1. Proces verbali dhe Vendimi i mbledhjes se asamblese se ortakeve date 26.05.2006.
2. Vendimi i mbledhjes se dates 04.04.2007.
3. Urdheri leshuar nga Ministri i Ministrise se Ekonomise, e Trgetise dhe Energjitikes,Z.Genc Ruli, Nr.2016/1 Prot date 30.03.2007.

"FORALB ALABASTER" SH.P.K
NIPT J62903844I
Mengaj/ Kavaje/Tirane

PROÇES- VERBAL
I
MBLEDHJES
SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"FORALB ALABASTER" sh.p.k, date 23.10.2015

Ne Tirane sot më datë 23.10.2015, ora 12.00, diten e premte, ne zyren e noterise Tirane, me seli në Rr. Durresit, Blloku Gintash, Godina 10/a , para meje noteres publike Ilirjana Tabaku, Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, u zhvillua mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Foralb Alabaster" , me rend dite si me poshte:

1. Kalimin ne masen 45% te kuotave të zotëruara nga ortaku Enea Leoncini, shoqerise "Alesio 2014" sh.p.k.

Te pranishem ne mbledhje jane :

1. Z. Enea Leoncini , zoterues i 74.99 % te kapitalit dhe
2. Znj. Gjinovefa Arizaj, perfaqesuese e Ortakut Shteteror, zoterues i 25% te kapitalit, sipas autorizimit nr. 7754/1 kol, date 21.10.2015 , te leshuar nga Ministri Arben Ahmetaj, Minister i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes,

E pranishme eshte dhe perkthyesja Zj. Irada Peçi.

Ortaku Enea Leoncini, e deklaron mbledhjen te hapur dhe diskuton per piken e pare te rendit te dites dhe shpreh vullnetin e tij per kalimin ne masen 45% te kuotave të zotëruara nga ai vete shoqerise "Alesio 2014" sh.p.k.

Zj. Gjinovefa Arizaj, lexon autorizimin nr. 7754/1 prot, date 21.10.2015, sipas te cilit autorizohet te perfaqesoje ortakun shteteror dhe bazuar ne shkresen nr. 7754/2 prot, date 21.10.2015 " Qendrimi qe do te mbahet ne mbledhjen Asamblese se Pergjithshme ..."miraton piken e pare te rendit te dites, " Kalimin e 45 % te kuotave te zoteruara nga Enea Leoncini, shoqerise "Alesio 2014" sh.p.k.

Mbledhja e asamblese se ortakeve te shoqerise, në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin Për Shoqëritë Tregtare, duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar,

VENDOSI

1. " Kalimin e 45 % te kuotave te zoteruara nga Enea Leoncini, shoqerise "Alesio 2014" sh.p.k.
2. Ngarkohet z. Enea Leoncini per te regjistruar ndryshimet ne QKR.

TRADUTTRICE GIURATA
DELLA LINGUA ITALIANA
23 OCT 2015
IRADA PEÇI
PERKTHYESE E MIRATUAR
Irada Peçi

SH.P.K. Import - Export
FORALB ALABASTER
MENGAJ - KAVAJE - ALBANIA

Pjese e ketij procesverbali jane

1. Autorizimi nr. 7754/1 kol, date 21.10.2015 , te leshuar nga Ministri Arben Ahmetaj, Minister i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes.
2. Shkresa nr. 7754/2 prot, date 21.10.2015 " Qendrimi qe do te mbahet ne mbledhjen Asamblese se Pergjithshme ..."
3. Shkresa nr. 7754 prot, date 12.10.2015 te shoqerise "Foralb Alabaster" sh.p.k.

Ne perfundim administratori Enea Leoncini e deklaron mbledhjen te mbyllyr.

ORTAKET E SHOQERISE
"FORALB ALABASTER" SH.P.K

SH.P.K. import - Export
FORALB ALABASTER
KAVAJE - ALBANIA

TRADUTTRICE GIURATA
DELLA LINGUA ITALIANA
23 OCT 2015
IRADA PEÇI
PERKTHYESE E MIRATUAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE ILIRJANA I TABAKU

TAKSA E PULLES
U PAGUA

Nr 2448 Rep.

Nr 1362/1 Kol.

Tirane, 28.10.2015

Adresa: Tirane, Rr. Durresit, Blloku Gintash, Godina 10/a

KONTRATË SHITJE

Sot, më datë 28.10.2015 (dymijë e pesembedhjete), para meje noteres publike Ilirjana Tabaku, Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rr. Durresit, Blloku Gintash, Godina 10/a , u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Z. ENEA LEONCINI**, atesia Anton, lindur me 06.08.1942 , banues ne Tirane, ne adresen Rr. Durresit, nr. 102, me dokument identifikimi karte identiteti leshuar nga Republika Italiane, nr. AO 6796658, shtetas italian , madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne cilesine e ortakut zoterues te 74.99% te kapitalit te shoqerise **"FORALB ALABASTER" SH.P.K,** pajisur me NIPT J62903844I.

- **SHOQERIA "ALESIO-2014"** sh.p.k, me seli ne Tirane, Rr. Lord Bajron, banese private nr. 14, regjistruar si person juridik me date 13.05.2014, pajisur me NIPT L41713003M, perfaqesuar nga administratori dhe njekohesisht ortaku i vetem Z. Anton Gjinaj, atesia Ndue, lindur me 08.04.1966 ne Kryezi –Puke, banues ne Tirane, ne adresen Rr. Gjergj Legisi, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me dokument identifikimi leternjoftim ID 030794001, nr. personal G60408041I, shtetas shqiptar, pale të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate me termat si më poshtë vijon:

Duke qenë se ekzistojnë keto kushte paraprake:

1. **Shoqeria "FORALB ALABASTER" sh.p.k, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , regjistruar si person juridik me date 08.11.1994 , me zyre qendrore ne Mengaj, Kavaje, Tirane, pajisur me NIPT L52108186M, me kapital prej 30.980.000 (tridhjetemilion e nenteqind e tetedhjete mije)leke, me dy ortake.**

2. Z. Enea Leoncini, është nje nga ortaket e shoqerise qe zoteron masen prej 74.99 % të kapitalit të shoqërisë, me vlere 23.234.000 (njezete e tre milion e dyqind e tridhjete e kater mije)leke, i cili ka vendosur të shese masen prej 45% te kuotes se kapitalit, qe i eshte ofruar per shitje shoqerise "ALESIO -2014" , e cila e ka pranuar blerjen sipas vendimit te asamblese date 23.10.2015.
3. Shitja eshte miratuar nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise **"FORALB ALABASTER" sh.p.k,** e cila ka dhene pelqimin sipas vendimit te asamblese date 23.10.2015 .

Palët bien dakord për hartimin e kësaj kontrate shitje si më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ALESIO - 2014
sh.p.k.
NUIS : L41713003M
TIRANE - ALBANIA

NENI 1.- OBJEKTI

Shitesi i shet bleresit masen prej 45 % te kuotes që zotëron në kapitalin e shoqërisë në gjendjen e faktit dhe të te drejtave në të cilën ndodhet, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi kuoten

NENI 2- CMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES

Cmimi i shitjes i vendosur me marreveshje te paleve eshte ne total 5.600.000 (pesemilion e gjashteqind mije) LEKE dhe palet deklarojne se eshte likujduar plotesisht jashte kesaj zyre noteriale.

NENI 3- GARANCITË

Shitesi deklaron dhe garanton se është pronar i vërtetë i mases prej 45 % të kuotes se kapitalit te Shoqërisë. Shitesi deklaron gjithashtu se kuota e kapitalit eshte nënshkruar dhe shlyer prej tij në tërësinë dhe se kuota eshte e lire nga cdo barrë apo pretendim i të tretëve.

Bleresi ka pranuar blerjen e mases prej 45 % të kuotes qe zoterohet nga shitesi, sipas vleres se percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate dhe deklaron se ka likujduar totalisht jashte kesaj zyre noteriale .
Bleresi garanton se me blerjen e mases prej 45 % te kuotes qe zoterohet prej shitesit, merr persiper te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga pronësia mbi kuoten.

NENI 4- KALIMI I PRONËSISË

Me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, shitesi do të humbasë të drejtat e tij mbi pronësinë e mases prej 45% të kuotes se kapitalit te shoqerise , duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi te.
Nga ana tjetër, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, bleresi do të bëhet pronar i mases prej 45 % te kuotes se kapitalit të shoqërisë , me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi te.
Kapitali i Shoqërisë Tregtare **"FORALB ALABASTER" sh.p.k,** pas realizimit dhe regjistrimit të kësaj kontrate shitje do të zotërohet si më poshtë vijon:

- Shoqeria "ALESIO – 2014" - 45 % te kapitalit.
- Enea Leoncini– 29.99 % te kapitalit.
- Ortaku Shteteror - 25 % te kapitalit.

NENI 5- SHPENZIMET E KONTRATËS

Shpenzimet noteriale dhe të hartimit të kësaj kontrate janë në ngarkim të Bleresit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ALESIO - 2014
sh.p.k.
NUIS : L 41713003M
TIRANË - ALBANIA

NENI 6- LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Çdo aspekt që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë do të disiplinohet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratave të shitjes dhe legjislacionit tregtar në fuqi.

NENI 7- ZGJIDHJA E MOSMARRËVSHJEVE

Në rast mosmarrëveshjeje rreth zbatimit dhe interpretimit të kësaj kontrate, palët bien dakord ta zgjidhin atë në rrugë miqësore. Në rast se kjo nuk është e mundur, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata.

NENI 8- DISPOZITA TË FUNDIT

Sa me siper iu perkthye shtetasit italian Enea Leoncini, ne gjuhen italiane, nga perkthyesja zyrtare Irada Kristofor Peçi , e njohur prej meje dhe e pranuar prej tij , e cila me deklaroi se pasi i perktheu gjithcka nga shqip ne italisht , e kuptoi dhe e pranoi.
Kjo kontratë u hartua ne katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me tre flete, dhe, pasi iu lexua palëve qarte e me ze te larte nga une noteri dhe u gjet në përputhje me vullnetin e tyre te plotë dhe të lirë ,u nënshkrua prej palëve të kësaj kontrate pa asnjë vërejtje përpara meje Noterit .
Une Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALËT

SHITESI

BLERESI
"ALESIO-2014"
Perfaqesuar nga administratori

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ALESIO - 2014
sh.p.k.
NUIS : L41713003M
TIRANË - ALBANIA

NOTERE
ILIRJANA I TABAKU

TRADUTTRICE GIURATA
DELLA LINGUA ITALIANA
28 OCT 2015
IRADA PEÇI
PËRKTHYESE E MIRATUAR

Taksa e Pullës
U Pagua

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Notere: *ERNITA HAXHIU*
Nipti: *L61730017A*
Nr. 819 **Rep.**
Nr. 690 **Kol.**

KONTRATE SHITJE TE PJESEVE TE KAPITALIT

Sot, në Tiranë, më datë 29 / 12 / 2018, përpara meje Notere Ernita Haxhiu u paraqitën personalisht palët e mëposhtme :

Vijon si me poshte:

Shitesi: **Z. Enea Leoncini,** shtetas Italian, atesia Anton, lindur me 06/08/1942 Rocca San Casciano dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Durresit nr 102", Karta e Identitetit Nr. **AY0868826** madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar; referuar me poshte si **"Shitesi".**

Bleresi: **Shoqeria "ALESIO – 2014" shpk,** person juridik shqiptar regjistruar ne regjistrin tregtar identifikuar ne organet tatimore me NUIS nr L41713003M me seli ne adresen Njësia Bashkiake Nr. 11, Rruga "Lord Bajron", Ndërtesë Dy Katëshe Nr.14,me perfaqesues ligjor Z. Anton Gjinaj shtetas shqiptar, i biri i Ndues i datelindjes 8/4/1966 i lindur ne Kryezi dhe banues ne Tirane, ne adresen Rruga ".Gjergj Legisi" me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga Karta e Identitetit Nr G60408041I referuar me poshte si **"Bleresi".**

Palet bien dakort per hartimin e kesaj Kontrate Shitje te Pjeseve te Kapitalit si me poshte:

Te pergjithshme

(A) Shoqeria "FORALB ALABASTER" Sh.p.k., eshte nje shoqeri qe ekziston sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me ane te vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr. 7160 date 04.11.1994, me seli ne Mengaj, Kavaje, Shqiperi (referuar me poshte si **"Shoqeria").**

- Kapitali i Shoqerise eshte i ndare ne 30.980.00 (tridhjete mije e nenteqind e tetedhjete) pjese.
- Ortaket e Shoqerise jane Z. Enea Leoncini, Shoqeria "ALESIO-2014" shpk dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes sot Ministria e Financave dhe Ekonomise.
- Administratori i Shoqerise eshte Z. Enea Leoncini.

(B.) Shitesi zoteron 9.291,00 (nente mije e dyqind e nentedhjete e nje) pjese ne kapitalin e Shoqerise, te cilat perfaqesojne 29.99 % te kapitalit te Shoqerise.

(C) Bleresi zoteron pjese 13.941,00 (trembedhjete mije e nenteqind e dyzet e nje) pjese ne kapitalin e Shoqerise te cilat perfaqesojne 45,00 % te kapitalit te Shoqerise dhe nepermjet kesaj kontrate te shitjes se kuotave do te perfitoj pjese sipas kushteve te percaktuara me poshte.

(D) Shitja eshte miratuar nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve , permes vendimit te Asamblese date 20.12.2018, e cila do i bashkangjitet kesaj kontrate si pjese perberese dhe e pandare e saj.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr. 7850, date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", nenet 705-757, "Kontrata e Shitjes" dhe ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te ndryshuar me ligjin nr. 10475 date 27.10.2011 dhe me ligjin nr. 129/2014, specifikisht neni 73 germa b (Shitblerje), "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave".

Neni 1

Objekti

1.1. Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e **9.291,00** (nente mije e dyqind e nentedhjete e nje) **pjeseve te kapitalit te Shoqerise**, te cilat perfaqesojne 29.99 (njezet e nente pike nentedhjete e nente) % te Kapitalit te Shoqerise. Keto pjese transferohen nga Shitesi ne pronesi te Bleresit.

1.2 **Bleresi** pranon pronesine mbi **9.291,00** (nente mije e dyqind e nentedhjete e nje) pjeseve te kapitalit te Shoqerise, te cilat perfaqesojne **29.99** (njezet e nente pike nentedhjete e nente) **% kuotave te Kapitalit te Shoqerise** dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo pronesi.

1.3. Si rezultat te kesaj shitje shitesi nuk i mbeten ne pronesi te tij asnje pjese te kapitalit te shoqerise.

Neni 2

Cmimi i shitjes dhe Menyra e Pageses

Cmimi total i shitjes per objektin e percaktuar ne nenin 1 te kesaj Kontrate, i vendosur me marreveshje ndermjet paleve eshte **3.000 EURO (tre mije euro)** ne numerin e llogarise se Z. Enea Leoncini ne momentin e nenshkrimin e kontrates.

Neni 3

Shitja dhe Kalimi i Pronesise

3.1. Shitesi konfirmon qe ja shet **29.99 (njezet e nente pike nentedhjete e nente) % kuotave** Bleresit dhe Bleresi konfirmon qe e pranon kete shitje, si rrjedhim Shitesi i kalon pronesine e Bleresit te **29.99** % te pjeseve e kapitalit te Shoqerise.

3.2. Sipas kesaj kontrate shitjeje Shoqeria "FORALB ALABASTER" Sh.p.k., perbehet nga ortaket: Ortaku "ALESIO – 2014" shpk i cili zoteron 74.99 % te kapitalit te kesaj shoqerie, nga Ortaku Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes sot Ministria e Financave dhe Ekonomise e cila zoteron 25 % te kapitalit te shoqerise.

Neni 4

Regjistrimi

4.1. Shitesi dhe Bleresi pranojne te zbatojne e te japin, me kerkese te Bleresit dhe/ose Shoqerise, te gjithe dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per shitjen e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per te regjistruar kete shtije ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) si edhe ne cdo organ tjeter shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

Neni 5

Garancite dhe Detyrimet e Shitesit

5.1. Shitesi garanton Bleresin qe ka tagra te plota per te lidhur kete kontrate ne menyre te vlefshme.

5.2. Bleresi garanton Shitesin se u njeh te gjitha te drejtat dhe detyrimet mbi kuotat qe behet pronar sipas gjendjes qe ndodhen kuotat ne momentin e kesaj shitjeje.

5.3. Shitesi disponon te gjitha te drejtat dhe eshte pergjegjes per gjitha detyrimet e shoqerise deri ne momentin e nenshkrimit te kontrates, cdo e drejte dhe detyrim do ti kalojne Blersit vetem pas nenshkrimit e kesaj kontrate.

Neni 6

Garancia dhe Detyrimet te Bleresit

6.1. Bleresi pranon se njeh aktet e Shoqerise "FORALB ALABASTER" Sh.p.k., akt themelimi dhe statut si dhe cdo akt qe rregullon veprimtarine e shoqerise dhe i pranon ato sikurse jane dhe garantojne zbatimin e tyre.

6.2. Bleresi pranon dhe garanton Shitesin se njeh te gjitha te drejta dhe detyrimet mbi kuotat qe behet pronar sipas gjendjes qe ndodhen kuotat ne momentin e shitjes.

6.3. Bleresi pranon dhe garanton se njeh cdo te drejte dhe detyrim qe ka shoqeria ne menyre propocionale me kuotat qe jane pronare, si rrjedhoje e kesaj shitjeje.

Neni 7

Te ndryshme

7.1. Palet garantojne se ata e kane lexuar dhe kane kuptuar kete kontrate dhe nenet e saj.

7.2. Kjo kontrate mes paleve eshte nje e tere persa i perket objektit dhe revokon te gjitha diskutimet dhe marreveshjet e meparshme te paleve.

7.3. Pjese perberese e kesaj kontrate eshte edhe vendimi i Asamblese se Ortakeve per shitjen e pjeseve te kapitalit.

7.4. Kjo kontrate, si dhe cdo marreveshje apo dokument tjeter qe ka lidhje me te, do te ekzekutohen dhe interpretohen sipas Ligjit Shqiptar. Juridiksioni kompetent eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

7.5. Kjo kontrate eshte pergatitur ne 5 (pese) kopje me vlere te njejte ligjore dhe se bashku me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "FORALB ALABASTER" Sh.p.k., do te depozitohen prane QKB.

Kontrata eshte bazuar ne artikullin 705-756 Kodit Civil dhe Ligjin Nr. 9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" date 14.04.2008, te ndryshuar.

Kontrata u lexua para paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, dhe u nenshkrua ne menyre te rregullt nga palet

SHITESI

Z.ENEA LEONCINI

BLERESI

Shoqeria "ALESIO-2014"

Administrator

Z. Anton Gjinaj

NOTERE
ERNITA HAXHIU
TIRANË

VENDIM I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"Foralb Alabastër" SH.P.K.
Datë: 20 Dhjetor 2018

Sot më datë 20.12.2018, ora 14.00 , u mblodh asambleja e jashtëzakonshme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**Foralb Alabastër" sh.p.k.**, e cila mbahet pranë ambienteve të shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë. Kjo mbledhje u mbajt në vijim të njoftimit te dates 12/12/2018, për thirrjen e Asamblese së Ortakëve nga administratori dorezuar prane Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, dt 12/12/2018 dhe njoftuar po ne te njejten dite edhe ortakun tjetër Alesio- 2014 shpk. Shoqëria For Alb Alabastër shpk, e regjistruar në Shqipëri, me seli në Mengaj, Kavajë me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT: J62903844I

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë, e cila u zhvillua në prani të TRE ORTAKËVE përbëhet nga
Enea Leoncini i paisur me kart identiteti nr. AY0868826, që zotëron 29.99% të kuotave të shoqërisë

Alesio-2014 shpk me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 45% të kuotave të shoqërisë

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si ortak i 25% të kuotave përfaqësuar nga Znj. Gjinovefa Arizaj me autorizimin nr 22110/1 datë 20/12/2018 e cila u paraqit në mbledhje e asamblesë

duke e bërë të vlefshme mbajtjen dhe vendimarrjen e kësaj asambleje , procedoi me shyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës si më poshtë

- Kalimin e kuotave 29.99% të zotëruara nga ortaku Enea leoncini, shoqërisë Alesio 2014 shpk

E pranishme cilësinë e mbajtjes së proces verbalit dhe të vendimit të asamblesë si dhe te përkthyeses eshte Znj. Albana Ahmeti e paisur me pasaporte me BA3368434

Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga ortaku Enea Leoncini. Axhenda e mbledhjes është:

Në mbledhje marrin pjesë të TRE ORTAKËT

1. Ortaku Enea Leoncini shpreh vullnetin e tij të lirë për t'i kaluar 29.99% të kuotave, që zotëron, shoqërisë "Alesio 2014" shpk
2. Ortaku Shteteror, nëpërmjet përfaqësuesit të saj Znj. Gjinovefa Arizaj sipas Autorizimit nr 22110/1 datë 20/06/2018 dhe Qëndrimit të Ministrit me shkresën nr 22110/2 datë 20/12/2018, me te cilin miraton, kalimin e kuotave 29.99% që zotëron ortakut Enea leoncini , tek shoqëria Alesio 2014 shpk.
   dhe
3. Alesio-2014 shpk me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 45% të kuotave të shoqërisë shpreh miratimin dhe vullnetin e tij për kalimin e kuotave nga zotëruesi Enea Leoncini tek Alesio 2014 shpk në masën 29.99%.

SH.P.K. Import - Export FORALB ALABASTER KAVAJE - ALBANIA

Mbledhja e asamblesë së shoqërsië, në mbështetje me statutin e shoqërisë dhe Ligjit nr 9901 date 14/04/20078," Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar, duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar

V E N D O S Ë N:.

1. Kalimin e 29.99% të kuotave të zotëruara nga Enea Leoncini, shoqërisë Alesio 2014 shpk.
2. Ngarkohet Z. Enea Leoncini me cilesine e administratorit te kryeje regjistrimin e ndryshimeve prane QKB-se .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

Ortaku Italian

Enea LEONCINI

Perfaqesuesi i Ortakut shtet

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë

Znj. Gjinovefa ARIZAJ

Ortaku

Alesio-2014 shpk

Anton Gjinaj

Mbajtesja e proces-verbalit te mbledhjes, Vendimit të asamblese dhe perkthyesja

Albana Ahmeti